



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.597/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.P Hashani OP më seli në Lipjan me nr. të biznesit 810369654, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, për shkak të anulimit të Vendimit me Nr. 15.Nr.463-14811 te datës 04.08.2019 dhe 15.Nr.463-48449 te datës 19.07.2019, jashtë seancës, me datë 27.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HEDHET** padia e paditësit N.T.P Hashani OP më seli në Lipjan me nr. të biznesit 810369654, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, për shkak të anulimit të Vendimit Vendimit me Nr. 15.Nr.463-14811 te datës 04.08.2019 dhe 15.Nr.463-48449 te datës 19.07.2019, si e paplotësuar
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi N.T.P Hashani OP nëpërmjet përfaqësuesit J.H. nga Prishtina me datën 13.07.2020 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. 08/2018/2 të datës 18.05.2020

Gjykata me datë 17.05.2024 ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në prezencën e përfaqësuesit të paditësit J.H., pronar i biznesit dhe të përfaqësuesit të palës së paditur B.K., zyrtar i lartë ligjor.

Pas fjalës hyrëse të palëve dhe administrimit të provave të bashkangjitura në padi, gjykata konstatoj se paditësi nuk i ka specifikuar arsyet e kontestimit te vendimit dhe nuk i ka bashkangjitur vendimet e kundërshtuara, andaj gjatë seancës me procesverbal morri aktvendim me të cilin

detyroj paditësin që në afat prej 8 ditëve nga dita e mbajtjes së seancës, ta bëjë plotësimin e padisë duke i specifikuar vendimet e kundërshtuara, në të kundërtën gjykata do ta hedh poshtë padinë si të paplotësuar.

Pala paditëse edhe pas kalimit të afatit gjyqësor, nuk i ka kryer veprimet procedurale si në aktvendimin e datës 17.05.2024.

Bazuar ne Ligjit për Konfliktet Administrative, nenit 33 nenit 33, Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që: *brenda afatit prej tetë (8) ditëve t'i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, dhe Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.*

Andaj, gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet për hedhjen e padisë, dhe vendosi si në pikën I të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.597/22, datë 27.05.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.